



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

RAPORT VJETOR 2016 PËR VEPRIMTARINE E AUDITIMIT TE BRENDSHËM NË MPJ

I.Përmbledhje Ekzekutive:

Veprimtaria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) është e orientuar nga objektivat e Ministrisë si dhe nga detyrimet që përcakton ligji për auditimin e brendshëm, në funksion të përmirësimit të menaxhimit të fondeve publike dhe përdorimit të tyre me kursim, dobi dhe frytshmëri.

Drejtimet kryesore të veprimtarisë audituese edhe në vitin 2016 kanë qenë vlerësimet e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të riskut dhe konkretisht nëse:

- Veprimtaritë e përfaqësive janë në pajtueshmëri me politikat, procedurat, ligjet dhe rregulloret e miratuara.
- Burimet janë përdorur me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- Asetet publike janë ruajtur dhe përdorur me efektivitet;
- Informacionet financiare, janë të sakta, të besueshme dhe në kohën e duhur;

Gjatë këtij viti Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në MPJ, ka organizuar punën e saj për një përdorim efektiv të burimeve në dispozicion në funksion të arritjes së objektivave. U realizuan 17 auditime të plota. Në auditimet e realizuara i është dhënë prioritet subjekteve me kohën më të gjatë të paudituar që varion nga 5-6 vite.

Me qëllim shkurtimin e kostove të auditimeve e cila është e konsiderueshme kjo për shkak të largësisë gjeografike që subjektet e varësisë kanë më njësinë qendrore, janë bërë përpjekje që në një udhëtim të kryhen disa auditime në vendet pranë njëri tjetrit për të kursyer në maksimum shpenzimet për udhëtim dhe dieta. Gjithashtu auditimet janë kryer në minimumin e mundshëm kohor, duke bërë të mundur kryerjen e auditimeve sa më cilësore në një kohë sa më të reduktuar.

Të dhëna përmbledhëse për vitin 2016

- Janë realizuar 17 angazhime auditimi
- Janë dhënë 152 rekomandime për marrjen e masave organizative për ndreqjen e parregullsive dhe përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm
- Është dhënë 1 rekomandim për masë administrative (zgjidhje e kontratës së punës)
- Janë dhënë 10 rekomandime për zhdëmtimin e arkës në vlerë 2.6 milion lekë
- Një çështje është dërguar për investigim të mëtejshëm pranë Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave

Auditimet e realizuara për çdo vit gjatë periudhës 2010-2016




Figura 1. Auditimet e realizuara gjatë periudhës 2010-2016

Rekomandimet e dhëna nga grupet e Auditimit për përmirësimin e sistemeve të veçanta të kontrollit të brendshëm apo për marrjen e masave të zhdëmtimit gjithmonë janë marrë parasysh nga titullari i Ministrisë. Janë përpiluar aktet administrative përkatëse për rregullimin e sistemeve të kontrollit dhe vënien në ngarkim të personave përgjegjës shumat e përfituara në kundërshtim me ligjin.

Gjithashtu janë marrë në konsideratë nga menaxherët e përfaqësive diplomatike rekomandimet e dhëna nga auditimi për rregullimin e sistemeve të kontrollit dhe të metave të konstatuara dhe janë marrë masat për të zbatuar të gjitha detyrat e lëna nga auditi.

II. Baza Ligjore

Funksionimi i auditimit të brendshëm në MPJ bazohet në Ligjin Nr.144/datë 22.10.2015 “ Për auditimin e brendshëm në sektorin publik, akte të tjera nën ligjore të cilat rregullojnë këtë veprimtari si dhe praktikat profesionale

ndërkombëtare që përmbajnë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Brendshëm.

III. Organizimi i DAB

Misioni i DAB në MPJ: Dhënia në mënyrë të pavarur e sistematike të një sigurie të arsyeshme për titullarin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për të përmirësuar veprimtarinë e subjektit publik dhe frytshmërinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në zbatim të ligjit është një njësi që varet nga Ministri i Punëve të Jashtme dhe si strukturë harmonizimi dhe raportimi ka edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik, pjesë e së cilës është edhe Drejtoria për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave. Struktura e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në MPJ është 1+4, respektivisht 1 drejtor dhe 4 specialistë, nga të cilët 2 juristë dhe 2 ekonomistë.

IV. Rezultatet e veprimtarisë së AB.

Analiza e programeve të AB për vitin 2016.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në vitin 2015 ka realizuar 17 auditime të kombinuara.

Gjatë këtij viti Plani i auditimeve është rishikuar dhe ka patur shmangie nga plani fillestar i auditimeve për 3 përfaqësi.

Analiza e Misioneve të AB.

Për realizimin e planit vjetor DAB ka bërë një organizim total të punës së saj duke u mbështetur në vlerësimin e riskut, fluksin e punës dhe realizimin e objektivave. Në fokus të veprimtarisë ka qenë përmirësimi i frekuencës së auditimeve me qëllim auditimin në një kohë sa më të shpejtë të atyre subjekteve të cilave u ka kaluar ndjeshëm afati i auditimit. Janë realizuar minimumi dy auditime në muaj, me qëllim auditimin në një kohë sa më të shpejtë të këtyre subjekteve pasi një pjesë e përfaqësive të audituara gjatë 2016 kishin një periudhë reaktivisht të gjatë 5-7 vite pa u audituar.

Gjatë këtij viti janë audituar përfaqësi të cilat nuk ishin audituar asnjëherë më parë si ambasadat në vendet e Gjirit Persik (Emiratet e Bashkuar Arabe, Kuvajti dhe Katar), Ambasada në Bratislavë dhe Ambasada në Izrael e cila nuk ishte audituar që në vitin 2007.

Vlerësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, Drejtoria e auditimit është fokusuar në 5 komponentët kryesorë :

- Mjedisi i kontrollit, si funksionon në MPJ dhe subjektet e vartësisë duke marrë në konsideratë specifikën e saj, meqenëse subjektet e vartësisë i ka në një largësi të madhe gjeografike nga qendra.
- Vlerësimin që Drejtoria i ka bërë riskut dhe menaxhimit të tij, duke identifikuar sistemet dhe subjektet me risk më të lartë.
- Sistemin e informacionit dhe komunikimit, që lidhen me çështjet dhe subjektet që janë audituar.
- Aktivitetet e kontrollit: (autorizimi, rishikimi, procedimi, kontrolli fizik, dokumentimi dhe ndarja e detyrave).
- Monitorimi i aktiviteteve të kontrollit. Veprimtari mbi monitorimin për raportimin financiar , konsullor, diplomatik etj,

Mbi bazën e këtyre vlerësimeve janë identifikuar fushat me risk më të lartë si më poshtë :

1. Risqet në Sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore

- 1.1Ndryshimi i vazhdueshëm i stafit diplomatik në krye të përfaqësisë
- 1.2Ndryshimi i stafit teknik, veçanërisht të personave të ngarkuar me financën.

2. Risqet në Sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit

- 2.1 Emërimi i personave të pakualifikuar për mbajtjen e financës nëpër përfaqësi si rezultat i nivelit të ulët të pagave.

3. Risqet për Sistemin e Prokurimeve

- 3.1 Pamundësia e zbatimit të legjislacionit për prokurimin publik nëpër përfaqësi për shkak të mungesës së stafit të nevojshëm në numër
- 3.2. Mungesa e specialistëve të fushës.

4. Risqet për Sistemet e Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar

- 4.1 Mungesa e stafit profesionist që mbajnë financën nëpër përfaqësi
- 4.2 Ndërrimi i stafit gjatë kohës që nuk është kryer auditimi.
- 4.3 Mundësia e fshehjes së të dhënave.

5. Risqet e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit

5.1 Mungesa e një programi të njehsuar për mbajtjen e kontabilitetit nëpër përfaqësi dhe lidhjen on –line me Drejtorinë e Financës.

6. Risqe të tjera lidhur me sisteme specifike sipas misionit dhe qëllimit të institucionit, (investimet publike, të ardhurat, etj)

6.1 Fusha e të ardhurave konsullore.

6.2 Ligjshmëria e kontratave të qerave.

6.3 Investimet në përfaqësitë tona diplomatike pronë e shtetit shqiptar që janë në administrim të DSHTD-së.

Gjetjet kryesore sipas sistemeve

Problemet kryesore që janë vënë re gjatë kryerjes së auditimeve në përfaqësitë diplomatike për vitin 2016 mbi aktivitetin ekonomiko-financiar dhe gjithë performancën e veprimtarisë së tyre paraqiten si më poshtë:

Sistemi i Prokurimeve

- Mungesa e procedurave dhe formularëve të blerjeve me vlera të vogla sipas kërkesave të Ligjit për Prokurimin Publik.

Sistemi i Pagesave

- Pagesa në kundërshtim me VKM 673, datë 11.09.2003 "Për të drejtat e punonjësve në përfaqësitë tona diplomatike"

- Pagesa dietash në kundërshtim me VKM përkatëse dhe urdhëresat e Ministrit të Jashtëm.

Sistemet e Proçeseve Organizative

Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore

- Mungesë e një rregullorjeje të brendshme dhe ndarje detyrash në përfaqësi

- Mungesë trainimi për të ngarkuarit me mbajtjen e financës.

Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit

- Mungesa e sistemeve të kontrollit në lidhje me zbatimin e buxhetit dhe respektimin e limiteve buxhetore në total dhe për zëra të vecantë.

- Mungesa e normativave në lidhje me shpenzimet korrente kryesisht shpenzimet për energji, ujë, ngrohje, karburant.

- Mungesa e udhëzimeve lidhur me përdorimin e financimeve të huaja dhe/ose sponsorizimeve nga donatorë të ndryshëm.

- Mangësi në drejtim të ngritjes së sistemeve të kontrollit për shpenzimet “pritje përcjellje”.

Sist. i Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar

- Mangësi në mbajtjen e kontabilitetit dhe pasqyrave financiare.
- Mangësi në drejtim të administrimit të vlerave materialeve dhe financiare.
- Mbajtja e dokumentacionit financiar jo në përputhje me ligjin nr.9228 datë 29.04.2004.
- Mosmbajtja e dokumentacionit për magazinën konform Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" dhe udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit Publik".
- Mosmbajtja e dokumentacionit për makinat sipas urdhrit të Ministrit nr.507, datë 15.10.2012 "Për përdorimin e automjeteve në Përfaqësitë Diplomatike dhe Konsullore të R.SH-së.

Sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të institucionit (të ardhurat, mbajtja e dokumentacionit etj)

- Mangësi në ndjekjen e procedurave konsullore dhe regjistrimin e veprimeve konsullore sipas manualit konsullor.
- Mangësi në sistemet e ngritura për sistemimin e dokumentacionit.
- Mangësi në procedurat dhe hartimin e gjurmës së auditimit në rastet e mbylljes së përfaqësive diplomatike.

Cështjet e dërguara për investigim

Nga auditimi i kryer ne Ambasadën e RSH në Ankara, Turqi, për periudhën 01/12/2013 deri në 30/04/2016 u evidentuan disa shkelje lidhur me cështje të menaxhimit financiar si dhe ndjekje të procedurave të prokurimit publik për fondet e donatorëve të cilat u dërguan për investigim të mëtejshëm pranë Inspektimit Financiar në Ministrinë e Financave si dhe pranë Agjensisë së Prokurimit Publik. Pasi cështjet u trajtuan nga këto dy institucione ka dalë urdhri i Ministrit të Financave me masat përkatëse të cilat duhet të ndërmerren nga Ambasada Ankara.

V. Rekomandimet

Drejtoria e auditimit gjatë vitit 2016 ka përcaktuar si prioritet rritjen e cilësisë së rekomandimeve të dhëna dhe zbatimin e tyre përmes rritjes së bashkëpunimit me subjektet e audituara me qëllim ndreqjen e parregullsive dhe përmirësimin e menaxhimit dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm. Pothuaj në të gjitha rastet janë marrë në konsideratë nga menaxherët e përfaqësive diplomatike rekomandimet e dhëna nga auditimi për rregullimin e sistemeve të kontrollit dhe të metave të konstatuara dhe janë marrë masat për të zbatuar të gjitha detyrat e lëna nga auditi.

Rekomandimet e dhëna nga grupet e Auditimit për përmirësimin e sistemeve të veçanta të kontrollit të brendshëm apo për nxjerrjen e urdhërave për kthimin në arkën e shtetit për dëmet ekonomike të konstatuara janë marrë parasysh nga titullari i Ministrisë. Janë përpiluar menjëherë aktet administrative përkatëse për rregullimin e sistemeve të kontrollit dhe vënien në ngarkim të personave përgjegjës shumat e përfituara në kundërshtim me ligjin. Por zbatimi i detyrave me karakter zhdëmtues apo disiplinor mbetet problem pasi në të shumtën e rasteve punonjësit ndaj të cilëve janë marrë këto masa nuk janë më pjesë e stafit të subjektit të audituar dhe një pjesë e tyre edhe nuk jetojnë në Shqipëri.

Duke marrë shkas nga të metat e konstatuara nga auditimet e kryera janë dhënë rekomandime në mënyrë specifike për çdo rast, dhe në mënyrë të përmbledhur sipas fushave të përcaktuara më poshtë dhe konkretisht:

Në fushën e prokurimeve

- Në rastet e kryes së blerjes së mallrave për përfaqësinë të ndiqen procedurat në zbatim të ligjit "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tij.

Në fushën e pagesave

- Të bëhet një rishikim i Vendimit të Këshillit të Ministrave që rregullon pagat e diplomatëve në zbatim të Ligjit të Ri të Shërbimit të Jashtëm, të rishikohet grupimi i përfaqësive sipas nivelit të kostos së jetesës.
- Të ndiqet respektimi i limitit celular në zbatim të VKM-së nr.864, datë 23.07.2010 "Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik" i ndryshuar, si dhe Qarkoret e MPJ mbi zbatimin e buxheteve për vitet përkatëse.

Në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit

- Hartimi i një manuali për menaxhimin financiar e kontrollin në përfaqësi, me qëllim njësimin e procedurave dhe sistemeve në një standart të përbashkët.
- Hartimi i një programi softëare për t'u lidhur me gjithë përfaqësitë online në kohë reale me qëllim kontrollin e mbajtjes së kontabilitetit direkt.
- Rishikimi i bazës ligjore për përfaqësitë tona diplomatike, përsa i përket Vendimit 673, 11.09.2003 "Për të drejtat e punonjësve të përfaqësive diplomatike të R.Sh në shtetet e huaja", në zbatim të Ligjit të Ri të Shërbimit të Jashtëm.(kjo duhet paralelisht edhe me rishikimin e VKM për pagat, pasi çështjet e trajtuara më poshtë i prekin të dyja këto VKM)
- Të gjitha transaksionet financiare të kryhen nëpërmjet rrugëve bankare, në zbatim të urdhërit të Ministrit të Punëve të Jashtme nr.171, datë 27.04.2004 si dhe udhëzimit të Ministrisë.

- Vendosja e limiteve për shpenzimet për energji apo ngrohje si dhe normat e harxhimit për karburantin e makinave
- Rregullimi i procedurave dhe gjurmës së auditimit në përfaqësi për shpenzimin e fondit për pritje përcjellje.
- Për Ambasadat e RSH në vendet e Gjirit Persik, këto përfaqësi në bashkëpunim me MPJ duhet të planifikojnë në Programin Buxhetor Aftamesëm të gjitha fondet e nevojshme (përfshirë fondet për qeranë dhe stafin teknik) për të siguruar vijueshmëri dhe qëndrueshmëri të aktivitetit të tyre për vitet në vijim, në funksion të arritjes së objektivave të politikës së jashtme që Qeveria Shqiptare ka në këto vende.
- Hartimi i gjurmës së auditimit nga MPJ në lidhje me përdorimin e fondeve të dhuruara nga shtetet pritëse si financim i huaj, nëse ky financim do të vazhdojë.
- Hartimi i gjurmës së auditimit nga MPJ për mënyrën e menaxhimit dhe raportimit të fondeve të sponsorizuara, në përputhje dhe me kërkesat e ligjit nr.7892, datë 21.12.1994 “Për sponsorizimet” i ndryshuar dhe akteve ligjore që rregullojnë fushën e fondeve buxhetore.

Në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore

- Hartimi i një rregulloreje të brendshme për Aparatin e MPJ –së , si dhe në çdo përfaqësi.
- Hartimi i organikave dhe vendosja e sistemeve të duhura të kontrollit në rastin e emërimeve nëpër përfaqësi të stafit teknik. Nxjerrja e akteveve nënligjore në zbatim të legjislacionit në fuqi lidhur me caktimin e pozicioneve administrativo-teknike në përfaqësitë tona diplomatike.
- Stafi teknik i emëruar në përfaqësi të bëjë një trajnim të detyrueshëm në MPJ para se të marrë detyrën

Në fushën e veprimeve konsullore:

- Të hapen rregjistrat konsullorë sipas formateve përcaktuar në Manualin Konsullor. Rregjistrat duhet të jenë të veçantë për çdo veprim konsullor dhe të jenë të sekretuar sipas modeleve që shoqërojnë manualin.

Në fushën e mbajtjes së dokumentacionit e të tjera

- Të sistemohet arkiva e Përfaqësive konform urdhërit të Ministrit të Punëve të Jashtme nr.276, datë 05/08/2014, për miratimin e “Rregullores për punën me dokumentet dhe arkivat në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore të RSH”.
- Të hartohet gjurma e auditimit për procedurat që duhet të ndiqen në rastin e mbylljes së përfaqësive diplomatike

VI. Monitorimi i sistemit dhe sigurimi i cilësisë

Monitorimi i punës së auditimit të brendshëm është realizuar nga Drejtuesi i DAB mbështetur në dokumentacionin që lidhet me rishikimet e angazhimeve të auditimit dhe që janë plotësuar nga një anëtar më me përvojë i grupit të auditimit, pasi në strukturën e kësaj drejtorie nuk ka Përgjegjës Sektori i cili të jetë i ngarkuar me këtë funksion.

Për të realizuar sigurimin e cilësisë së punës së auditimit, është bërë një rishikim i përgjithshëm i dokumenteve të punës nga Drejtuesi i DAB i cili ka siguruar titullarin se veprimtaria e auditimit është realizuar në përputhje me planet vjetore dhe strategjike dhe se produktet e veprimtarisë audituese ndihmojnë realizimin e objektivave të Ministrisë së Punëve të Jashtme me ekonomi, efektivitet dhe eficiencë.

VII. Analiza e kapaciteteve audituese.

Struktura e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në MPJ është 4+1, respektivisht 1 drejtor dhe 4 specialistë, nga të cilët 2 juristë dhe 2 ekonomistë, gjë që bën të mundur kompozimin e grupeve të auditimit me 2 persona nga të cilët njëri është jursit dhe tjetri ekonomist. I gjithë stafi i DAB është çertifikuar si « Auditues të brendshëm në sektorin publik » në respekt të kriterit ligjor.

Shpenzimet vjetore për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore për stafin e DAB në 2016 janë 6.2 milion lekë. Shpenzimet operative për shpenzime udhëtimi dhe dieta llogariten mesatarisht 200-250 mije lekë per një udhëtim dhe në total kostoja mestare është 3.7 milion lekë .

Për zhvillimin profesional të audituesve gjatë vitit 2016, në kuadër të bashkëpunimit me strukturën përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave është organizuar trainimi i detyrueshëm ku kanë marrë pjesë të gjithë antarët e stafit të DAB.

Duke vlerësuar bashkëpunimin tonë të vazhdueshëm me këtë strukturë, mendojmë që edhe në të ardhmen duhet të vazhdojnë trajnime të mëtejshme për audituesit, veçanërisht trajnime të drejtimit praktik, sipas standarteve. Nevojat për trainim janë pasqyruar edhe në formularët e vlerësimit vjetor për secilin punonjës.

VIII. Konkluzione

DAB për vitin 2016 ka realizuar planin vjetor e strategjik si dhe ka arritur objektivat e saj, duke përdorur me eficiencë burimet në dispozicion në funksion

të përmirësimit sistemeve të kontrollit të brendshëm për një menaxhim më të mirë nga MPJ të fondeve publike dhe përdorimit të tyre me kursim, dobi dhe frytshmëri.

Për vitin 2017 prioritet për DAB do të vazhdojnë të jenë :

- Përmirësimi i frekuencës së auditimeve duke mbuluar me auditim Përfaqësi të paaudituar, veçanërisht ato që kanë një periudhë mbi 3-4 vite pa u audituar. (15 auditime të planifikuara)
- Përmirësimi i sistemeve të kontrollit të brendshëm mbi bazën e gjetjeve në përfaqësi dhe rekomandimeve për rregullimet përkatëse administrative dhe ligjore.
- Rritja e kompetencës së stafit me programe të diferencuara trajnimi në lidhje me metodat dhe praktikat e reja të auditimit të brendshëm në sektorin publik.